




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority
Nr. i Prot./Bc./Prot./Prat. No. 747/24-11/D
Nr. i Fq./Bc./Sl./No. Pg. 1/2
Data/IXatimi/Date: 25.11.2024
PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA

Nr. 102/2024

Datë: 25.11.2024

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 26, 27, 35, 36 dhe neni 55 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4, të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2023, Për Procedurën e Paraqitjes së Kërkesës Për Lejimin e Përqendrimit dhe Kriteret Për Konstatimin e Përqendrimit dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2023, për përcaktimin e Tregut Përkatës, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës, nxjerrë këtë:

KONKLUZION

Me të cilin, konstaton se, nuk ka kushte për fillimin e procedurës për vlerësim të Përqendrimit, sipas nenit 36 të Ligjit 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, ndaj ndërmarrjeve, Ujë Rugove dhe Ujë Kllokoti.

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës, më 28.05.2024, ka bërë kërkesë për mbledhjen e të dhënave në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës - ARBK dhe më 19.07.2024 ka ftuar në takim përfaqësues të ndërmarrjes Ujë Rugove SH.P.K. me NUI: 810505406, me adresë: Rr. "Hasan Prishtina", Obiliq dhe Banja e Kllokotit Fabrika e Ujit Mineral & CO2 SH.P.K. me NUI: 810545618, Viti.

Monitorimi / Shqyrtimi paraprak Objekti i çështjes

Marrëdhënia/raporti, ndërmjet ndërmarrjeve Ujë Rugove dhe Ujë Kllokoti, respektivisht dyshimi për realizim të një përqendrimi të panotifikuar. Ndërmarrja Ujë Rugove, është ndërmarrje që operon me emër tregtar Ujë Rugove SH.P.K. me NUI: 810505406, me adresë: Rr. "Hasan Prishtina", Obiliq e cila aktivitet kryesor ka prodhimin e pijeve freskuese dhe prodhimin e ujit natyral në shishe dhe Ndërmarrja Ujë Kllokoti, është ndërmarrje që operon me emër tregtar Banja e Kllokotit Fabrika e Ujit Mineral & CO2 SH.P.K. me NUI: 810545618, Viti, e cila aktivitet kryesor e ka prodhimin e ujit mineral/të gazuar.

Baza ligjore:

Autoriteti, ka filluar monitorimin/shqyrtimin paraprak në tregun përkatës, bazuar në dispozitat ligjore, përkatësisht, nenin 11 paragrafët 1, 2, 3 me nënparagrafët 3.1 dhe 3.2, nenin 13 paragrafi 1, nenin 15, neni 20 paragrafi 1 me nënparagrafin 1.2, neni 29 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3., neni 34, neni 36 paragrafi 3 me nënparagrafin 3.1, dhe nenin 39, i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, Udhëzimi Administrativ Nr. 01/2023, për përcaktimin e Tregut Përkatës dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2023,

1

për Procedurën e Parashtrimit të Kërkesave për Lejimin e Përqendrimit dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit, Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës sipas detyrës zyrtare, pas marrjes së informatave, ka krijuar dyshimin e arsyeshëm se ndërmarrjet, Ujë Rugove dhe Ujë Kllokoti kanë një kontratë për shitblerje.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, vlerësojmë se kjo marrëveshje nuk bie në dispozitat e nenit 11 të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, përkatësisht nuk kualifikohet si përqendrim.

Poashtu bazuar në paragrafin 6 të nenit 36, Komisioni ka konstatuar se, nuk janë përmbushur kriteret e lartëcekura, lidhur me detyrimin për të njoftuar përqendrimin, pasi që marrëveshja ndërmjet ndërmarrjeve Ujë Rugove dhe Ujë Kllokoti ka vetëm qëllim distribuimi.

Nga sa më lartë, Komisioni i Autoritetit duke u bazuar në nenin 55 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, u vendos si në dispozitiv të këtij Konkluzioni. Obligohet Sekretariati që të kujdeset për zbatimin e këtij konkluzioni.

Ky konkluzion, hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga ana Komisionit.

AUTORITETI I KONKURRENCËS

Komisioni

Neime Binaku - Isufi

Kryetare



Kaltrina Sela
Nënkryetare

Nafije Osdautaj
Anëtare



Florent Mehmeti
Anëtar



Salihe Gashi - Loku
Anëtare



Këshilla juridike: Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa, por pala me padi mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.

Me këtë KONKLUZION të njoftohen:

- Palë/ndërmarrjet në monitorim/shqyrtim paraprak
- Publikohet në web faqen e Autoritetit
- Arkiva